

LIGJ
Nr. 121/2020

**PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE
TË BASHKUARA TË AMERIKËS LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN PËR
PËRDORIMIN E INFORMACIONEVE PËR UDHËTARËT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës lidhur me bashkëpunimin për përdorimin e informacioneve për udhëtarët, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 7.10.2020

Shpallur me dekreten nr. 11793, datë 19.10.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN PËR
PËRDORIMIN E INFORMACIONEVE MBI UDHËTARËT**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Brendshme, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përfaqësuar nga Departamenti i Sigurisë së Brendshme i Shteteve të Bashkuara (DSB), Agjencia për Mbrojtjen Doganore e Kufitare të SHBA-së (AMDK), (në tekstin e mëtejshëm të referuar si “Palët”),

duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar të të dyja shteteve;

duke njohur përfitimet e marrëdhënies bashkëpunuese midis Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, veçanërisht, në minimizimin e rreziqeve që lidhen me shfrytëzimin kriminal dhe terrorist të udhëtimit ndërkombëtar;

duke njohur nevojën dhe përfitimin e analizimit dhe vlerësimit të informacionit mbi udhëtarin, si një mjet për të luftuar krimin ndërkufitar dhe kërcënimet e tjera ndaj sigurisë kufitare;

duke dëshiruar rritjen e sigurisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Republikës së Shqipërisë;

duke dashur të japin mbështetje të dyanshme në identifikimin e udhëtarëve të paligjshëm dhe prirjet e udhëtimit në përputhje me mandatet e tyre përkatëse;

duke njohur se nëpërmjet këtij Memorandumi Bashkëpunimi (“MB”) të dyja Palët përfitojnë falë përmirësimit të aftësive për të identifikuar dhe ndjekur kriminelë ndërkombëtarë, të njohur apo të dyshuar; zbulojnë kërcënime të mundshme ndaj sigurisë së vendeve të tyre; si dhe zbulojnë më shumë informacion rreth rrjeteve dhe veprimtarive kriminale ndërkombëtare;

duke njohur se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka mbështetur miratimin e këtij MB; dhe

duke kërkuar, brenda këtij konteksti të bashkëpunimit të intensifikuar, shqyrtimin e mundësive për nisma të tjera dypalëshe, përfshirë bashkëpunimin në programe këshillimore, kontrolli dhe ndihme, si dhe programe trajnimi e shkëmbimi midis Palëve, synimi i të cilave është që të sjellin përfitime për të dyja vendet,

arrijnë mirëkuptimin për sa vijon:

Neni 1

Përkufizimet

“Informacion mbi udhëtarin” do të thotë informacion personal në lidhje me udhëtarë specifikë, përfshirë këtu pasagjerët dhe ekuipazhet, të cilët përputhen me parametrat e përcaktuar bashkërisht nga DSB/ADMK dhe Departamenti për Kufirin dhe Migracionin. Ky informacion pritet të përfshijë:

- informacionin paraprak për pasagjerët (API): të dhëna specifike biografike mbi pasagjerin dhe ekuipazhin, si dhe hollësi të tjera mbi fluturimin, të mbledhura përpara nisjes dhe të dorëzuara te një autoritet shtetëror i caktuar nga transportuesi në lidhje me fluturimet brenda ose jashtë territorit të Palës; dhe

- të dhënat për emrat e pasagjerëve (PNR): të dhënat e krijuara nga kompanitë e fluturimit apo agentët e autorizuar prej tyre, për çdo udhëtim të rezervuar nga apo në emër të çdo pasagjeri, dhe të cilat gjenden në sistemet e rezervimit të kompanisë së fluturimeve tregtare, sistemet e kontrollit të nisjeve apo sisteme ekuivalente, të cilat kanë funksionalitete të ngjashme, në lidhje me fluturimet brenda ose jashtë territorit të Palës.

Neni 2

Fusha dhe qëllimi

Nëpërmjet këtij memorandumi bashkëpunimi, Palët, duke u mbështetur mbi mekanizmat aktualë të suksesshëm për përdorimin e informacionit mbi udhëtarin për të identifikuar rreziqe të mundshme ndaj sigurisë, kanë si qëllim ngritjen e një kuadri për bashkëpunim në vlerësimin dhe shqyrtimin e informacionit mbi udhëtarin. Qëllimi i këtij memorandumi bashkëpunimi është të garantojë siguri dhe të mbrojë jetën dhe sigurinë e publikut. Për këtë arsye, Palët do të punojnë për të parandaluar, zbuluar, hetuar dhe ndjekur penalisht terrorizmin dhe krimin me karakter ndërkombëtar.

Neni 3

Parimet e bashkëpunimit

A. Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, në varësi të disponueshmërisë së fondeve dhe, sipas rastit dhe siç është autorizuar me ligj, synon të:

Marrë të gjithë hapat e nevojshëm për t’u kërkuar të gjitha kompanive të fluturimeve tregtare të dorëzojnë informacionin mbi udhëtarët, në kohë reale, te Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, duke u mbështetur te bashkëpunimi i ministrive apo i agjencive të tjera të Republikës së Shqipërisë sipas nevojës;

Mundësojë personel të dedikuar për të shqyrtuar të gjithë informacionin mbi udhëtarin;

Sigurojë transferim në kohë reale të informacionit mbi udhëtarin te DSB/AMDK;

Sigurojë të paktën të njëjtën shkallë konfidencialiteti për informacionin mbi udhëtarin, të pranuar sipas këtij memorandum bashkëpunimi, ashtu siç zbatohet për informacione të ngjashme mbi udhëtarin nën kujdesin e tij; dhe

T'i ofrojë nëpërmjet kanaleve të përshtatshme, aq sa autorizohet nga ligjet dhe politikat në fuqi, vlerësime rreziku që Departamenti për Kufirin dhe Migracionin ka bërë për informacionin mbi udhëtarin drejtuar DSB/AMDK, për qëllimet e mëposhtme:

- të ndihmojë në identifikimin e rreziqeve apo kërcënimeve ndaj sigurisë, të panjohura më parë;

- të zbulojë apo të ndjekë rrjete apo veprimtari kriminale ndërkombëtare, si dhe rreziqe të tjera ndaj sigurisë kufitare;

- të identifikojë dhe të ndalojë kriminelë ndërkombëtarë dhe kërcënime të tjera, gjatë kalimeve kufitare;

- të identifikojë persona të cilët mund të përbëjnë rrezik ndaj sigurisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Republikës së Shqipërisë; dhe

- për qëllime të tjera të ngjashme, në përputhje me këtë memorandum bashkëpunimi, të cilat mund të përcaktohen bashkërisht nga Palët.

B. DSK/AMDK, në varësi të disponueshmërisë së fondeve dhe, sipas rastit dhe siç është autorizuar me ligj, synon:

Të ndihmojë Departamentin për Kufirin dhe Migracionin me asistencë për zhvillimin e mjeteve teknike për shqyrtimin e informacionit mbi udhëtarin, për qëllimet e përshkruara në nenin 3.A;

Të shqyrtojë informacionin mbi udhëtarin, marrë në kuadër të këtij memorandum bashkëpunimi;

Të sigurojë të paktën të njëjtën shkallë konfidencialiteti për informacionin mbi udhëtarin, të marrë në kuadër të këtij memorandum bashkëpunimi, ashtu siç zbatohet për informacione të ngjashme mbi udhëtarin nën kujdesin e tij;

T'i ofrojë nëpërmjet kanaleve të përshtatshme, aq sa autorizohet nga ligjet dhe politikat në fuqi, vlerësime rreziku që DSB/AMDK ka bërë për informacionin mbi udhëtarin drejtuar Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, për qëllimet e mëposhtme:

- të ndihmojë në identifikimin e rreziqeve apo kërcënimeve ndaj sigurisë, të panjohura më parë;

- të zbulojë apo të ndjekë rrjete apo veprimtari kriminale ndërkombëtare, si dhe rreziqe të tjera ndaj sigurisë kufitare;

- të identifikojë dhe të ndalojë kriminelë ndërkombëtarë dhe kërcënime të tjera, gjatë kalimeve kufitare;

- të identifikojë personat që mund të përbëjnë një kërcënim për sigurinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Shqipërisë; dhe

- qëllime të tjera në përputhje me këtë MB, të cilat mund të përcaktohen bashkërisht nga Palët.

Të njoftojë Departamentin për Kufirin dhe Migracionin nëpërmjet kanaleve të përshtatshme, në rast të ndonjë përputhjeje mes emrave apo informacioneve të tjera të dhëna nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin drejtuar DSB/AMDK apo për listat e identifikuara në mënyrë të ndërsjellë të udhëtarëve që paraqesin rrezikshmëri të lartë.

C. Secila Palë planifikon të mbledhë, ruajë, përdorë dhe shpërndajë informacionin e marrë në kuadër të këtij memorandum bashkëpunimi, në përputhje me ligjet, politikat dhe detyrimet ndërkombëtare në fuqi.

Me hyrjen ne fuqi të këtij memorandumi bashkëpunimi, Palët synojnë të fillojnë diskutime për të zhvilluar procedura të mëtejshme për zbatimin e MB-së.

Këto procedura mund të përfshijnë: kërkesa specifike për pajisje (*hardware*) dhe programe (*software*) të teknologjisë së informacionit; nënshkrimin e një marrëveshjeje për sigurinë e ndërlidhjes; nxjerrjen e procedurave për shkëmbimin e vlerësimeve të rrezikut dhe përputhjet e përmendura në nenin 3, pika A dhe nenin 3, pika B; plotësimin e nevojave dhe objektivave për sigurimin e stafit dhe trajnimit, si dhe sigurimin e privatësisë dhe mbrojtje të tjera të nevojshme për trajtimin e duhur të informacionit mbi udhëtarin apo informatave të tjera të lidhura me këtë MB.

Neni 5

Kostot

A. DSB/AMDK, në varësi të disponueshmërisë së fondeve dhe, sipas rastit dhe siç është autorizuar me ligj, synon të sigurojë:

Personel të DSB/AMDK për të punuar me personelin e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin të caktuar në këtë program, për të ndihmuar me vënien në zbatim të kushteve të këtij memorandumi bashkëpunimi;

Pagat, transferimi dhe kostot e udhëtimit të personelit të DSB/AMDK gjatë trajnimit dhe detyrave të tjera, që kanë lidhje me zbatimin e këtij memorandumi bashkëpunimi;

Instrumentet e programeve kompjuterike për ruajtjen dhe analizimin e të dhënave të mbledhura në kuadër të këtij memorandumi bashkëpunimi; dhe

Kostot e transmetimit të të dhënave ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Shqipërisë, përfshirë tarifatat për pajisjet dhe transmetimin për realizimin e këtij memorandumi bashkëpunimi.

B. Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, në varësi të disponueshmërisë së fondeve dhe sipas rastit dhe siç është autorizuar me ligj, synon të sigurojë:

Qarqet për transmetimin e të dhënave nga autoritetet përkatëse shqiptare; për realizimin e këtij memorandumi bashkëpunimi;

Personel shtetëror të Shqipërisë, për të punuar me personelin e DSB/AMDK të caktuar për këtë program, në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit; si dhe

Pagat dhe kostot e udhëtimit të personelit shtetëror të Shqipërisë gjatë trajnimit dhe detyrave të tjera që kanë lidhje me zbatimin e këtij memorandumi bashkëpunimi.

Neni 6

Përfshirjet

Palët pranojnë që të gjitha veprimtaritë nën këtë memorandum bashkëpunimi i nënshtrohen marrëveshjes dypalëshe ekonomike ndërmjet qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e nënshkruar në Tiranë, më 10 qershor 1992 ("Marrëveshja ekonomike"). Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në përfshirjen nga tatimi (përfshirë detyrimet doganore), sipas nenit 3, të marrëveshjes ekonomike, për programet e asistencës së qeverisë së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, e cila parashikon, mes të tjerash, për sa vijon:

Çdo furnizim, material, pajisje ose fonde të futura, ose të marra në Republikën e Shqipërisë nga DSB/AMDK, ose nga ndonjë person ose ent i financuar nga DSB/AMDK, në mbështetje të këtij MB, do të përfshihen nga të gjitha taksat, kërkesat për investime ose depozita dhe kontrollet e valutës në Republikën e Shqipërisë.

Importi, eksporti, blerja, marrja në zotërim, përdorimi apo heqja dorë prej këtyre pasurive apo fondeve në lidhje me këtë memorandum bashkëpunimi janë të përfshijtura nga të gjitha tarifatat, detyrimet doganore, taksat mbi importin dhe eksportin, taksat mbi përfitimin ose blerjen ose

heqjen dorë, apo taksat mbi vlerën e shtuar, si dhe nga çdo taksë apo detyrime të ngjashme në Republikën e Shqipërisë.

Neni 7
Konsultimet

Një vit pas datës së hyrjes në fuqi të këtij MB, Palët presin që të konsultohen për efektshmërinë e tij duke bërë një vlerësim të përbashkët. Palët mendohet të zgjidhin çdo çështje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij MB ose ndonjë procedurë operationale në përputhje me to pas konsultimit midis Palëve.

Neni 8
Interpretimi

Ky memorandum bashkëpunimi nuk siguron të drejta apo detyrime në kuadër të legjislacionit kombëtar apo ndërkombëtar. Ky memorandum bashkëpunimi nuk ka për synim të krijojë, të akordojë, të japë apo të autorizojë ndonjë të drejtë, privilegj apo detyrim të një person apo ent, qoftë publik apo privat.

Neni 9
Data e hyrjes në fuqi dhe ndërprerja

Çdo Palë mund të ndërpresë pjesëmarrjen në këtë memorandum bashkëpunimi, por duhet t'i japë palës tjetër një lajmërim paraprak me shkrim 90 ditë përpara. Bashkëpunimi nën këtë MB pritet të fillojë që nga data e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me anë të së cilës Palët informojnë njëra-tjetrën në rrugë diplomatike, se procedurat e tyre përkatëse të brendshme të nevojshme për zbatimin e këtij memorandum bashkëpunimi janë përfunduar.

Nënshkruar në Tiranë, më 8.5.2020, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe angleze, të dyja tekstet janë barabar të vlefshme.

Për qeverinë e Republikës së Shqipërisë:

Sandër Lleshaj, Ministër i Brendshëm

Për qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës:

Yuri Kim, Ambasadore